


BLLOKOJE URREJTJEN NDËRMJET FEVE. SHPËRNDAJE DASHURINË.

BLLOKOJE URREJTJEN NDËRMJET FEVE. SHPËRNDAJE DASHURINË.

BLLOKOJE URREJTJEN NDËRMJET FEVE. SHPËRNDAJE DASHURINË.

BLLOKOJE URREJTJEN NDËRMJET FEVE. SHPËRNDAJE DASHURINË.

NDIKIMI I UDHËHEQËSVE FETARË TEK KOMUNITETET




Të dhënat që përmban kjo fletushkë informative rrjedhin nga [zhillimet e dala në konferencën](#) e parë rajonale për rolin e fesë në Ballkanin Perëndimor, që u mbajt në Tiranë më 11-12 qershor 2019, në kuadër të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim*.

MALI I ZI

◆ **44%** e të anketuarve të sondazhit e shohin fenë që të ketë ndikim negativ tek zhvillimi i marrëdhënieve ndëretnike.

◆ Një nga udhëheqësit fetarë gjithashtu vuri në dukje mënyrën se si media formëson opinionin publik: "Për ata [media], thelbi nuk qëndron tek vetë rrëfimi, por që të bëjnë që sa më shumë lexues ose shikues t'i lexojnë apo t'i shikojnë. Me këtë lloj qasjeje, të gjitha nismat e mira dhe shembujt e mirë të respektit të ndërsjellë dhe jeta në pjesët shumëetnike të vendit do të mbeten më pak të dukshme se sa incidentet".


Ndikimi i fesë në politikën dhe shoqërinë e Malit të Zi



MAQEDONIA E VERIUT

74% e të anketuarve konsiderojnë se feja në Maqedoninë e Veriut është e rëndësishme ose shumë e rëndësishme për njerëzit.


Të anketuarit identifikuan kërcënimet e mëposhtme për marrëdhëniet ndërfetare:



SERBIA

Marrëdhëniet ndërfetare do të vazhdojnë të përcaktohen nga faktorët politikë në Serbi dhe në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Disa nga këta faktorë politikë janë rritja e së djathtës së nacionalizmit, interesat e elitave politike etj.

Kërcënimet më të mëdha ndaj marrëdhënieve ndërfetare në Serbi



Gjuha e urrejtjes nuk është fjalë e lirë!

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës adresoi çështje në lidhje me intolerancën fetare në Rekomandimet e tij të Politikave të Përgjithshme.

Rekomandimi i Politikave të Përgjithshme Nr. 5 merret me luftimin e intolerancës dhe diskriminimit ndaj muslimanëve. Ky rekomandim mbron miratimin e një numri masash specifike për të luftuar intolerancën dhe diskriminimin e drejtuar kundër myslimanëve. Në këtë Rekomandim ECRI gjithashtu shpreh keqardhje që Islami ndonjëherë portretizohet në mënyrë të pasaktë mbi bazën e stereotipave armiqësore, efekti i së cilës është ta bëjë këtë fe të duket një kërcënim.

Rekomandimi i Politikave të Përgjithshme të ECRI-së Nr. 9 i kushtohet luftës kundër antisemitizmit. Ai përcakton një seri gjithëpërfshirëse të masave ligjore dhe të politikave për të ndihmuar Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës të luftojnë antisemitizmin, i cili duhet të përfshihet sistematikisht në një politikë më të gjerë kundër të gjitha formave të racizmit. Masa të tilla përfshijnë, ndër të tjera, forcimin e dispozitave të ligjit penal, rritjen e përpjekjeve për rritjen e ndërgjegjësimit në shkollë dhe mbledhjen sistematike të informacionit në lidhje me veprat antisemitike.

PRAKTIKA TË MIRA

OJQ-ja Rinia për Paqe, nga Bosnja dhe Hercegovina, në partneritet me Somborski Edukativni Centar nga Serbia dhe Udhetim i Lire nga Shqipëria ka zbatuar fushatën **#ALTerHate** Speech4Change. # Speech4Change është një platformë e krijuar nga të rinjtë e mbledhur rreth Rrjetit Evropian Rinor Ndërfetar të Feve për Paqe, e cila synon të luftojë gjuhën e urrejtjes përmes aktiviteteve të edukimit, sensibilizimit dhe avokimit për pranimin e diversitetit dhe përfshirjes përmes krijimit të narrativave alternative.

* (2019) "Roli i fesë në shoqëritë e Ballkanit Perëndimor – teksti i plotë" Punime të rastit për fenë në Evropën Lindore: Vëll. 39: Nr. 5, Artikulli 2. Gjendet në: <https://digitalcommons.georgefox.edu/ree/vol39/iss5/2>